

**STATUT I SHOQERISE**  
**"DNA GROUP" shpk.**

*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

Sot, me **22 / 07 / 2024**,

**Ensoel Neziri**, atësia Dylber, amësia Pranvera, shtetas Shqiptar, lindur në Peshkopi, Dibër dhe banues në Tiranë, me adresë Hamdi Pepa; Nd. 085; Njësia Administrative Nr. 6; Njesia Bashkiake Nr. 6; 1027; Tiranë, lindur më 30/04/1993, identifikuar nëpërmjet Leternjoftim ID nr. 033764492 dhe nr. personal J30430054L;

ne përputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratoi këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Sella**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më **22/ 07/ 2024**, themeluesi i mësipërm, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar "**DNA GROUP**" shpk.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: **Projektme arkitektonike për objekte civile, industriale, turistike, bujqësore, vepra arti; Projektme dhe studime urbanistike; Projektim interieri; Projektim dhe studim peisazhi, projektim rrugësh,ura, porte dhe vepra të tjera infrastrukturore; Projektme konstruksionesh të ndryshme dhe restaurime arkitekturore; Supervizion dhe mbikëqyrje punimesh; Menaxhim dhe koordinim projektesh të ndryshme; Konsulenca të ndryshme në lidhje me shërbimet e mësipërme. si dhe të ushtronte cdo aktivitet tjetër tregtar për sa kohë që nuk bie në kundërshtim me ligjin shqiptar, pavarësisht se nuk është përmendur specifikisht më lartë.**

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e **pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.**

**Neni 4**

**Selia**



Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Rr.Dibres; Pallati: 85; Shkalla: 1; Ap: 9, Tiranë, Shqipëri.**  
Me vendim te Administratorit, Shoqëria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

## **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **LEK 100.000 (njëqind mijë lekë)**. Ortaku themelues zotëron **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme 100.000 LEK që përben **100% të kapitalit themeltar të shoqërisë**. Kontributi i ortakut është në para dhe do të shlyhet prej tyre menjëherë me themelimin e shoqërisë. Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

### **Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe te shoqëritë kontrolluese dhe/ose te grupit te caktuara me vendimin e Asamblesë. Pjesët e kapitalit mund te kalohen te tretet vetëm me miratimin e Asamblesë se Përgjithshme, qe jepet nëpërmjet nje vendimi të mare me unanimitet. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 9

### Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një here në vit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve do të thirret nga Administratoret dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortaket.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të dërgohet me shkrim apo e-mail në adresat që secili Ortak do t'i njoftojë me shkrim Shoqërisë me poste të regjistruar. Njoftimi do të konsiderohet se i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës së 7-te pas dërgimit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përcaktojë qartë emrin e Shoqërisë, seline, datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, një përshkrim të hollësishëm të procedurës që duhet të ndiqet nga Ortaket për pjesëmarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyrën e marrjes së dokumenteve dhe projekt-vendimeve që duhet të vihen në dispozicion të gjithë Ortakeve, po ashtu edhe rendin e ditës, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve të paktën 7 (shtatë) ditë para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si më sipër duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

Ortaket mund të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet e komunikimit elektronik, që garantojnë identifikimin e ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.



Një Ortak mund të përfaqësohet në Asamblesë të Përgjithshme të Ortakeve nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Te gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratoret janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

#### **Neni 10 Kuorumi**

Me përjashtim të shkarkimit të administratorit, në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 11 Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me unanimitet, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

#### **Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### **Neni 13 Administrimi**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.



Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi caktohet Z. **Ensoel Neziri**, shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 30/04/1993, lindur në Peshkopi, Dibër, mbajtës i Leternjoftim ID nr. 033764492 dhe nr. personal J30430054L.

#### Neni 14

#### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### Neni 15

#### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme: u kthen ortakëve kontributet; u paguan ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndan aktivet shoqërisë; lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV** **Viti financiar-ekspertet**

##### **Neni 16** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17** **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### **Kreu V** **Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

##### **Neni 18** **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë: me vendim të Asamblesë së Ortakëve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës dhe për çdo rast tjetër të parashikuar në ligj.

Nëse vendoset prishja e shoqërisë në gjendjen e aftësisë pagueuse, ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri në likuidim e sipër". Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortakët.

#### **Neni 19**

#### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare. Nëse nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua, nga ortaku themelues si vijon:

**ORTAKU THEMELUES  
ENSOEL NEZIRI**

*Ensoel Neziri*

